



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT
KORÇË
VENDIM

Nr 31 Datë 13.06.2007

PËR
MIRATIM FONDI PËR KONCERTIN FESTIV QË DO TË HAPË
SEZONIN TURISTIK

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Sektori i Kulturës dhe Drejtoria e Financës për "MIRATIM FONDI PËR KONCERTIN FESTIV QË DO TË HAPË SEZONIN TURISTIK", bazuar në ligjin nr 8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 32 pika "dh", ligjin nr 8399 dt. 09.09.1998 "Për buxhetin lokal" neni 6, Udhëzimin nr 2 dt. 17.01.2007 i M.F. "Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2007", Udhëzimin nr 353 dt. 19.03.2007 të Ministrisë së Brendshme "Për zbatimin e Buxhetit të Qeverisjes Vendore për vitin 2007" si dhe V.K.B. nr. 2 dt. 02.02.2007 "Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2007", mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI

1. Të miratojë fondin prej 211 800 lekë (sipas preventivit të paraqitur në relacion), për koncertin festiv që do të hapë sezonin turistik.

2. Ky fond do të përballohet nga fondi rezervë i të ardhurave të Bashkisë me këtë strukturë buxhetore :

Pakësohet 00 04980 5 Art 6091100 - 211 800 lekë

Shtohet 00 08250 5 Art 6020000 + 211 800 lekë

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës, Sektori i Kulturës në Bashki dhe Qendra Ekonomike e Kulturës.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare e Këshillit
Raimonda Nase
Raimonda NASE